

KUSHTET E PERGJITHSHME TE KONTRATES PER SIGURIMIN E PERGJEGJESIE CIVILE NDAJ PALEVE TE TRETA NE MJETET UJORE.

1. DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Ligji nr. 10076 date 12.02.2009 "Per sigurimin e detyrueshem ne sektorin e transportit", ketu me poshte do te quhet shkurtim ligji. Rregullorja e Autoritetit Mbyqyrres Financiare miratuar me vendimin nr.53 date 25.06.2009 "Per trajtimin e demeve mbulohen nga kontrata e sigurimit te detyrueshem ne sektorin e transportit", ketu me poshte do te quhet shkurtimisht Rregullorja.

Kushtet e pergjithshme te kontrates per sigurimin e detyrueshem te mbajteseve te motoreve te ujit (JET), skafeve, yachtet , motorbarka, per pergjegjesine ndaj paleve te treta, ketu me poshte do te quhen shkurtimisht Kushtet e Sigurimit. Shoqeria e Sigurimeve **SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a** ketu me poshte do te quhet siguroesi. Personi fizik ose juridik, pergjegjesia civile e te cilit ndaj paleve te treta mbulohet sipas kontrates, do te quhet shkurtimisht i Siguruar.

2. OBJEKTI I SIGURIMIT

Siguroesi mbulon pergjegjesine civile te mbajtesit te mjetit ujore, ne perputhje me parashikimet e ligjit dhe te Rregullores dhe brenda kufijve te rene dakort, lidhur me demet jo pasurore (shendetesore) dhe pasurore te shaktuara ndaj paleve te treta per shkak te qarkullimit te mjetit te vogel ujur te siguruar.

3. SHTRIRJA TERRITORIALE.

Siguroesi mbulon pergjegjesine ndaj paleve te treta, ne kufijte e Ujra Territoriale te Republikes se Shqiperise, per shi Ujrat ne thellesi te ketij Teritori, qe perfshihen ne koordinatat gjeografike te percaktuara ne certifikatat e lejet e mjetit lundruar, te leshuara nga Autoritetet kompetente te Republikes se Shqiperise.

4. PERGJEGJESITE

4.1 Ne varesi te perjashtimeve dhe cilesimeve te deklaruara ne kete dispozite, Siguroesi do te mbuloje te Siguruarin, si dhe kedo tjetere qe ka ne kontroll mjetin lundruar me lejen e te Siguruarit, kundrejt pergjegjesise civile ndaj paleve te treta si rezultat i pronesise apo kontrollit te mjetit ujur, deri ne shumen kufi te Pergjegjesise ndaj Paleve te treta te deklaruara ne Legjislacionin ne fuqi.

4.2 Siguroesi, brenda shumese se deklaruar me siper, do te paguaje dhe shpenzimet gjyqesore qe behen me miratimin e Siguruesit per mbrojtjen ose ndjekjen e cdo procedure gjyqesore qe lind per apo ne lidhje me nje ngjarje qe sjell pergjegjesi qe mbulohen nga sigurimi duke perfshire procedurat perpara gjykates dhe procedurat per kufirin e pergjegjesise.

4.3 Siguroesi do te emerohet te marre persiper te drejte cdo procedure ligjore qe mbulohet sipas pikese 4.2 ne emer te cdo personi te mbuluar ne sigurim dhe te gjitha keta persona duhet te bashkepusojne teresisht me Siguruesin ne ndjekjen dhe /ose mbrojtjen e ketyre proceseve.

5. PERJASHTIME

Siguroesi nuk mbulon pergjegjesine e mbajtesit te mjetit lundruar ne rast se pergjegjesia lind nga:

- Cdo person qe ka ne kontroll mjetin lundruar per arsye te tjera pvec privatisht per kenaqesi;
 - Demet shendetesore qe pesojne personat e imbarkuar si ne mjetin shkakter te demit, ashtu dhe te atyre ne bordin e cdo mjeti tjetere lundruar;
 - Shkelje te detyrimeve qe rjedhin nga permbajtja e Certifikates se Lundrimit Certifikates se Sigurise dhe Lejes se Lundrimit;
 - Siguroesi nuk mbulon pergjegjesine ndaj paleve te treta per demet qe mund te ndodhin per shkak te pjesmarjes se mjeteve ujore ne gara apo konkurime sportive si dhe ne provat perkatese ose kur mbajtesi i mjetit lundruar angazhohet ne:
 - Ski ujore/ Ski qe terhiqen me motorskaf/Akuaplan/ Parashute ujore/ Apo aktivite te ngasme ndersa ata jane duke u terhequr nga mjeti lundruar ose duke u pergatitur per tu terheqje, as per pergjegjesine qe rjedhe nga persona te angazhuar jashte mjetit ujore ne ndonje nga keto aktivite.
 - Kur mjeti jepet me qira dhe nuk eshte marre me pare miratimi me shkrim i Siguruesit.
- Siguroesi nuk do te paguaje kerkesa per demshperblim per cdo gjobe apo denim te vendosur nga cilido Autoritet kompetent, ne pajtim me ligjet ne fuqi. Siguroesi nuk do te paguaje kerkesa per demshperblim per pergjegjesi nese mjeti lundruar i deklaruar ne Certifikate, merr pjese ne gara apo teste shpejtesie apo ne ngjarje lidhur me to.

6. TE DHENAT TEKNIKE E MJETIT LUNDRUES, DOKUMENTET

Te dhenat teknike te mjetit te vogel lundruar dhe dokumentet e tjere te nevojshem per leshimin e polices te paraqitura nga i Siguruar, agjenti ose menaxheri i tij perbejne bazen e kontrates midis tij dhe siguroesit. I Siguruar garanton saktesine e te dhenave te deklaruara dhe dokumenteve te paraqitura. Nese ndonje pjese e informacionit eshte e pavertete apo e padeklaruar, Siguroesi ka te drejte te nderprese kete siguracion qe prej fillimit tij apo te mos njohe pergjegjesite e tij ne rast demesh.

7. LUNDRIMI DHE PERDORIMI

Mjeti lundruar eshte i mbuluar ndersa lundron brenda kufijve te deklaruar ne Certifikatat e Lejet e leshuara nga Autoritetet kompetente, si edhe ndersa eshte i anchoruar. Ne cdo rast perjashtohen rastet e sigurimit te ndodhura pergjate rimorkimit e transportimit te mjetit ne toke, pvec rasteve kur mjeti lundruar i nenshtrohet procesit te leshimit te tij ne uje, apo i nenshtrohet kontroleve apo survejimeve periodike nga autoritet kompetente.

8. PERIUDHA E SIGURIMIT

Ky siguracion eshte i vlefshem per periudhat e treguar ne Certifikate pvec nderprejjes apo perfundimit ne perputhje me kushtet. Nese certifikata tregon nje periudhe me te vogel se 12 muaj ne vazhdim, ne varesi edhe te kushteve te treguara ne Certifikaten e sigurimit , ky siguracion eshte i vlefshem per kete periudhe me kusht qe barka te jete allaj dhe jo e gatshme per perdorim te menjehershem. Polica e sigurimit hyn ne fuqi ne oren 24.00 te dites se lidhjes se kontrates dhe mbaron ne oren 24.00 te dites se fundit te shenuar ne kontrate.

9. PERDORIM PRIVAT

Mjeti ujore duhet te perdoret vetem me perdorim privat dhe ne drejtimin e tij duhet te kete persona kompetente me miratim te te Siguruarit (te pajisur me Te drejten e Lundrim-Patenta - Detare) dhe nuk do te perdoret me qira apo hua pvec kur eshte rene dakord qe perpara se mjeti do te perdoret per qellim te tjera dhe I Siguruar ka rene dakord te paguaje primin shtese qe kerkohet. Nese bihet dakord qe mjeti mund te perdoret, jepet hua apo me qira, atehere mjeti ujore duhet te Certifikohet per kete aktivitet dhe gjate gjitha kohes te jete nen mbyqyrje nga

nje person i kualifikuar ne menyre te mjaftueshme dhe duhet qe gjate gjitha kesaj kohe te jete nen komanden e nje personi kompetent.

10. TRANSFERIMI I POLICES

Polica e sigurimit mund te transferohet sipas kerkeses se te Siguruarit ne rast se:

- Ndryshon pronesine e mjetit ujur te siguruar;
- Mjeti ujore pushon se ekzistuar dhe I Siguruar kerkon qe brenda periudhes se mbetur te mbuloje ne sigurim nje mjet tjetere ne pronesi te tij, kundrejt rillogaritjes se primit deri ne fund te periudhes se sigurimit.

11. KUJDESI I DUHUR

I Siguruar dhe Menaxheret e tij (nese ka) duhet qe te gjitha kohes te ushtroje kujdesin e duhur per te mbajtur mjetin ujur lundruar ne kushte te pershtatshme per lundrim, dhe te parandaloje ndotjen apo rrezikun e ndotjes si pasojte e demimit te mjetit ujore.

12. LIGJSHMERIA

Eshte nje kusht i ligji sigurimi qe i Siguruar dhe cdokush ne komanden e mjetit lundruar te jete ne perputhje me Kodin Detar te Republikes se Shqiperise, Rregullave Detare lokale dhe cdo ligji qe ka lidhje me te dhe te sigurohet qe mjeti lundruar ti pergjigjet cdo rregull sigurie te aplikueshem dhe fiton cdo leje apo license te kerkuar me ligj ne cdo vend qe ka juridiksion mbi ujerat ne te cilat lundron.

13. PROCEDURA E KERKESES PER DEMSHPERBLIM.

Mosqenja ne perputhje me kushtet e kesaj klauzole mund te paragjykoje kerkesen per demshperblim.

13.1 Nese nje ngjarje ben te linde nje kerkese per demshperblim sipas cdo seksioni te ketij Sigurimi, I Siguruar duhet te njoftoje sa me shpejte te jete e arsyeshme (e brenda 24 oresh-ne kapitenerine e Portit dhe prane Siguruesit);

13.2 I Siguruar duhet te marre te gjitha hapat e arsyeshem per te ndaluar apo per te minimizuar cdo humbje qe do te ishte e demshperblimeshme sipas ketij sigurimi dhe te minimizojte pergjegjesine ndaj paleve te treta.

13.3 I Siguruar duhet te bashkepusojte plotesisht me Siguruesin per te siguruar informacion dhe deshmite e duhura dhe duhet te lejojte siguroesin qe te procedoje ne emer te tij (por me shpenzimet e Siguruesit) per te fituar demshperblim nga ndonje pale e trete ne lidhje me mbulimet sipas ketij siguracioni.

13.4 Nese i siguaruar ben kerkese per demshperblim, apo deklarate qe ka lidhje me demshperblim, per te cilen Siguroesi ka djenen qe eshte falco apo mashtruese, apo kur i Siguruar nuk furnizon me informacione ne lidhje me kerkese per demshperblim, ky siguracion do te behet i pavlefshem qe prej fillimit te tij dhe do ti mbahej i gjitha primi i paguar.

13.5 Nese kerkesa per demshperblim eshte per koston e riparimit, i Siguruar duhet te sjelle te pakte dy kuotime per keto riparime.

13.6 Kerkesa per demshperblim do te paguhet vetem pasi te jete bere riparimi dhe i Siguruar ka bere deklaraten e pranimit te vleres.

13.7 Cdo njoftim i Siguruarit duhet ta jape te Siguruesi ne adresen e tij zyrtare te regjistruar ne QKR. Kushtet e mbulimit me sigurim, te Dhenat e Dokumentet e furnizuara nga I Siguruar dhe Polica e Sigurimit do te trajtohen nga Siguroesi dhe i Siguruar i nje te tere. Firmosja e Polices se Sigurimit nga Siguroesi dhe i Siguruar, presupozon se palet i kane lexuar, kuptuar dhe pranuar te gjitha te drejte te kufizimeve qe permban kjo kontrate.

14. MBROJTJA E TE DHENAVE PERSONALE

I Siguruar eshte njoher me deklaraten e privatesise te shoqerise se siguroesit dhe autorizon SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sh.a qe te mbledhe dhe perpunojte te dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet per administrimin e kontrates se sigurimit, per dhënen e shërbimeve ndaj te siguarit dhe perfituesit përfshirë trajtimin e demit, per ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në ligjet përkatëse në fuqi (Ligji Nr. 9887, date 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale") si dhe transferimin e të dhënave personale tek te tretë për qëllime të sigurimit apo biznesi të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale. Ne cdo rast, mbrojtja e te dhenave personale do te behet ne perputhje me rregullat dhe procedurat e percaktuara ne Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

15. E DREJTA E INFORMIMIT

15.1 I siguaruar ka te drejten te informohet nga Siguroesi mbi kushtet, procedurat dhe afatet e mbulimit dhe/ose perfitimit nga sigurimi, informim i cili fillon para nënshkrimit të kontratës dhe vazhdon gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës. Informimi merret nepermjet telefonit, e-mailit, faqes zyrtare ne internet apo broshurave informative te perdoruara nga shoqeria.

15.2 I siguaruar dhe/ose Policmbajtesi jane informuar nga Siguroesi përpara nënshkrimit të kontratës së sigurimit, duke marre te gjitha informacionin e nevojshëm në lidhje me te dhenat juridike te siguroesit, llojin përkatës të sigurimit, procedurat, afatet, metodat e trajtimit te kerkesave per demshperblim, rreziqet e mbuluara dhe te perjashtuara, metodat e llogaritjes, afatet dhe menyra e pageses se primit, metodën e llogaritjes se vleres se kompesueshme dhe cdo informacion tjetere qe ka lidhje me kontraten e sigurimit.

16. E DREJTA E TE SIGURUARIT PER TU ANKUAR

I siguaruar apo persona të tjerë të interesuar, kane te drejte të paraqesin një ankesë pranë shoqërisë së sigurimit, ne rast se cmojne se shoqeria e sigurimit nuk u përmbahet kushteve të vendosura në kontratën e sigurimit. Ankesa mund te paraqitet ne forme elektronike (e-mail) ose me shkrim ne adresen postare te shoqerise. Shoqëria e sigurimit do ti pergjigjet cdo ankesë të depozituar me shkrim apo në formë elektronike dhe do te jap cdo informacion të kërkuar që ka lidhje me kontratën e sigurimit, brenda afateve te percaktuara ne ligj.

Cdo mosmarreveshje ne lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate eshte ne varesi ekskluzive e juridiksionit te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane dhe i zbatueshem eshte Legjislacioni Shqiptar.

17. KUFIZIMET E SANKSIONEVE DHE KLAUZOLA PËRJASHTUESE

Pavarësisht dispozitave tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë sigurimi ofron mbulim për aq sa mbulimi me sigurim nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo klauzole gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, komerciale ose financiare dhe/ose embargo të leshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

Nënshkrimet e paleve ne policen e sigurimit vertetojne se kane rene dakort me informacionin e dhene paraparakisht, kane lexuar dhe kuptuar te gjitha termat dhe kushtet e kesaj kontrate sigurimi, dhe pranojne me vullnet te lire t'i respektojne zbatojne ato. keto kushte jane njoher dhe pranuar per tu respektuar dhe zbatuar nga perfituesi i kesaj kontrate i cili eshte dhe mbajtes i kontrates.